



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:100177
Datë: 19.07.2024
Numri i dokumentit: 05960534

K.Dh.Shk II.nr.532/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbare të kreditorit KS “Besa Security” Sh.p.k., me NRB:70191421, me seli në Prishtinë, Rr.“Jusuf Gërvalla” nr.64, kundër debitorit Universiteti “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, Rr.“UÇK” p.n, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1516/22 datës 21.12.2023, me datë 18.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit KS “Besa Security” Sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1516/22 datës 21.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1516/22 datës 21.12.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Universiteti “Haxhi Zeka”, është anuluar Urdhri Përmbare P.nr.1048/2021 i datës 30.11.2021, i Përmbaresit Privat Flamur S. Bogaj dhe ka përfunduar në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbare.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1516/22 datës 21.12.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KS “Besa Security” Sh.p.k., ka paraqitur propozimin për përmbaremore në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës me numër 4066-265-001-19 e datës 31.01.2019 dhe faturës me numër 809-265-150-19 e datës 30.06.2019, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrimit t’i paguaj kreditorit në emër të borxhit në shumën prej 1,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritshmërisë së kërkesës për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbaremit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbareuesi privat të zbatoj përmbaremin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin duke theksuar se dokumenti e besueshëm në bazë të cilit është lëshuar urdhri përmbaremore nuk përmban tipare të përmbareueshmërisë, faturat e cekura nuk janë të pranuar dhe të nënshkruara nga debitori, të njëjtat nuk janë në origjinal apo kopje e vërtetuar. Ka shtuar se urdhri përmbaremore është lejuar në kundërshtim të plotë me nenin 37 dhe 38 të LPP-së. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar, urdhri përmbaremore të anulohet.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se kontrata e

lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit është ndërprerë me datë 26.01.2021, ku debitori nuk ka bërë pagesën totale të obligimit që rrjedh nga kontrata dhe se për faturat debitori është njoftuar përmes email-it të datës 08.02.2021, dhe datës 10.09.2021, duke kërkuar përmbushjen e obligimit. Më tej ka shtuar se në prapësimin e bërë debitori tenton të ik nga përgjegjësia e tij dhe njëkohësisht të vë në lajthitje vet kreditorin dhe institucionet e tjera përkatëse, ka theksuar se kreditori mbetet pranë propozimit për përmbarim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1516/22 të datës 21.12.2023 në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Universiteti “Haxhi Zeka”, është anuluar Urdhri Përmbarimor P.nr.1048/2021 i datës 30.11.2021, i Përmbaruesit Privat Flamur S. Bogaj dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”* Po ashtu ka shtuar se fatura në bazë të cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të nejtat nuk përmbajnë as nënshkrimin dhe vulën e pranuesit-debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njejta është pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë, si dhe aktvendimin e ankimuar e ka mbështet edhe në nenin 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, e që në rastin konkret fatura me numër 4066-265-001-19 e datës 31.01.2019 dhe fatura me numër 809-265-150-19 e datës 30.06.2019, si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, të njëjtat nuk janë të vulosura e as nënshkruar nga debitori në mënyrë që të konsiderohen si dokumente të besueshme e po ashtu të njëjtat nuk janë në origjinal ashtu sipas nenin 37 të LPP-së me të cilën parashihet se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkangjitet dokumenti i tilëë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të kreditorit se faturat janë dërguar dhe pranuar nga debitori të njëjta i refuzoj si të pa bazuar ngase faturat me të cilën thiret kreditori nuk janë në origjinal ashtu si nenit 37 të LPP-së, po ashtu kjo gjykatë e refuzoj edhe pretendimin tjetër të kreditori lidhur me at se faturat janë dërguar përmes komunikimit elektronik, dhe të njëjtat fatura nuk janë kundërshtuar nga debitori, por këto pretendime i vlerësoj si të paqëndrueshme, pasi që nga komunikimet elektronike bashkangjitur në shkesat e lëndës nuk ka konfirmim të pranimit të faturave nga ana e debitorit së bashku me detyrimet që rrjedhin nga këto fatura.

Përndryshe në procedurën përmbaremore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaremore i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i

kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.532/24 me datë 18.07.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri